

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE OSNOVNI SUD

G.J.A-Su.A 37/23

Dt: 23/01/2023

PRISHTINË II PRISHTINA



REPUBLIKAE KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRISHTINA – BASIC COURT OF PRISTINA



GJA.nr 37/23

Dt23/01/ 2023

Raporti i rregullt i punës

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

(Janar - Dhjetor 2022)

PËRMBAJTJA

1. Gjykata Themelore në Prishtinë.....
2. Dega në Podujevë.....
3. Dega në Lipjan.....
4. Dega në Glllogoc.....
5. Dega në Graçanicë.....
- 1.0 Departamenti Special
- 1.1 Departamenti për Krime të Rënda.....
- 1.2 Departamenti për të Mitur.....
- 1.3 Departamenti për Çështje Administrative
- 1.4 Departamenti për Çështje Ekonomike
- 1.5 Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni për Çështje Penale.....
- 1.6 Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni për Çështje Civile.....
- 1.7 Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni për Kundërvajtje
- 2.1 Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni për Çështje Penale- Podujev
- 2.2 Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni për Çështje Civile- Podujev
- 2.3 Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni për Kundërvajtje- Podujev
- 3.1 Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni për Çështje Penale- Lipjan
- 3.2 Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni për Çështje Civile- Lipjan
- 3.3 Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni për Kundërvajtje- Lipjan
- 4.1 Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni për Çështje Penale- Glllogoc
- 4.2 Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni për Çështje Civile- Glllogoc
- 4.3 Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni për Kundërvajtje- Glllogoc
- 5.1 Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni për Çështje Civile- Graçanic
- 5.2 Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni për Çështje Penale- Graçanic
- 5.3 Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni për Kundërvajtje- Graçanic
6. Zyra e Personelit
7. Zyra e Financave
8. Zyra e Çertifikimit
9. Zyra e Logjistikes
10. Zyra per Informim Publik

Bazuar në nenin 14 paragrafi 2 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës nr. 06/L-054 dhe nenit 11 të Rregullores Nr.02/2020 Për organizmin dhe veprimtarinë e brendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës, Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, paraqet raportin e rregullt të punës për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2022. Gjykata me Degët e gjykatës në Podujeve, Lipjan, Gllogoc dhe Graçanicë.

Përmes këtij raporti prezanton në mënyrë përmbledhëse punën e gjykatës për vitin (Janar – Dhjetor) 2022, duke prezantuar njëkohësisht të arriturat, sfidat gjatë kësaj periudhe raportuese, si në aspektin profesional ashtu edhe në atë administrativ, me qëllim të paraqitjes së volumit të punës së kryer në formë statistikore dhe tabelore.

Në raport po ashtu përfshihet një pasqyrë e qartë për të gjitha kategoritë e lëndëve në gjykatë, kohëzgjatjen e zgjidhjes së lëndëve. Në raport përfshihen edhe të dhëna të tjera për kategoritë e ndryshme menaxheriale, administrative dhe profesionale për secilën degë të gjykatës, njësi – zyrë apo komisionin veç e veç, dhe një analizë e shkurtër për to. Të përfshira në raport janë edhe aktivitetet të cilat e kanë përcjell gjykatën, takimet e ndryshme që janë zhvilluar për këtë periudhë si dhe projektet e ndryshme të cilat janë duke u implementuar.

Gjykata Themelore në Prishtinë, gjatë vitit 2022, ka arrit që ti adresoj disa probleme dhe sfida që e kanë përcjell disa vite me radhe, në aspektin organizativ të punës dhe menaxhimit të burimeve njerëzore.

Është bërë riorganizimi i punës në administratën e gjykatës, në atë mënyrë që fillimisht janë identifikuar të gjitha burimet njerëzore në dispozicion brenda administratës së gjykatës. Pastaj është bërë shpërndarja e përgjegjësive për secilin punonjës brenda gjykatës, duke marrë në konsideratë organogramin e gjykatës, pozitat të cilat i mbajnë, përgjegjësitë që kanë sipas përshkrimit të vendit të punës dhe nevojave të gjykatës.

Për shkak të krijimit të Gjykatës Komericele, Gjykata Themelore e Prishtinës, është detyruar të bëjë riorganizimin të punës qoftë në aspektin e shpërndarjes së lëndëve për shkak se disa gjyqtarë kanë kaluar në këtë Gjykatë, po ashtu edhe në aspektin logjistik pasi që rreth 20 zyra të shfrytëzuara nga Gjykata Themelore i janë liruar kësaj gjykate për çka për gjykatën tonë ka paraqit sfida menaxhimi dhe vendosja e gjyqtareve tonë në zyra tjera.

Sfide tjetër ka qenë largimi i madh i gjyqtareve për shkak të avancimit në gjykata të shkalleve më të larta si dhe kalimit në Gjykatën Komerciale, si pasojë e së cilës diku rreth 20 mijë lëndë është dashur ti shpërndajmë tek gjyqtaret e gjykatës, e si pasojë e së cilës gjyqtaret aktual janë stergarkuar me lëndë, mesatarja e lendeve në Departamentin e Përgjegjshëm në Divizionin Civil aktualisht është mbi 1500 lende për gjyqtarë ndërsa në Divizionin Penal mbi 1200 lëndë për gjyqtare.

Gjatë vitit 2022, Gjykata Themelore në Prishtinë, përkundër përpjekjeve me angazhimin maksimal profesional të të gjithë të punësuarve – gjykatësve dhe kuadrit profesional, nuk ka

arrit që të zvogëloj numrin e lëndëve të grumbulluara në gjykatë, pasi që përpos numrit të madh të lëndëve të bartura nga vitet paraprake, gjatë vitit 2022 ka pas numër të madhe të lëndëve në ardhje si dhe zvogëlim të numrit të gjyqtareve.

Bazuar në këto rrethana nuk mund të jem e kënaqur plotësisht me arritjet e gjykatës që përfaqësoj, pasi jam e vetëdijshme për perceptimin e publikut ndaj gjyqësorit në përgjithësi, për numrin e lëndëve të grumbulluara në gjykatën tonë dhe zvarritjet që ndodhin për arsye objektive. Por, në anën tjetër, që nga fillimi i vitit 2022, kemi marrë përsipër të angazhohemi maksimalisht në rritjen e efikasitetit të gjykatës, zvogëlimin e lëndëve të vjetra, përmirësim të politikës ndëshkimore në gjykatë, të sigurojmë trajtim të barabartë para ligjit për secilin qytetar dhe të ndikojmë njëkohësisht në përmirësimin e imazhit të gjyqësorit në publik, po ashtu pres nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës që të rishikoj organogramin e Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe të rris numrin e gjyqtareve si dhe punëtorëve të gjykatës qoftë profesional edhe teknik, pasi që me rritjen e ngarkesës së punës është rritur nevoja për shtim të burimeve njerëzore.

Organizmi i Gjykatës Themelore në Prishtinë së bashku me degët e saj

Gjykata Themelore e Prishtinës është njëra nga shtatë gjykatat themelore në Republikën e Kosovës.

Gjykata Themelore e Prishtinës është e organizuar dhe funksionin me seli në Prishtinë (Pallati i Drejtësisë, Objekti A dhe D) dhe vepron për territorin e Komunës së Prishtinës, Fushë Kosovës, Obiliqit, Lipjanit, Podujevës, Glllogovcit dhe të Graçanicës;

Gjykata Themelore e Prishtinës ka këto degë: Dega në Podujevë për komunën e Podujevës; dega në Graçanicë për komunën e Graçanicës; dega në Lipjan për komunën e Lipjanit; dega në Glllogovc për komunën e Glllogovcit. dega në Fushë Kosovë për komunën e Fushë Kosovës dhe komunën e Obiliqi (nuk është funksionalizuar akoma).

Po ashtu, Gjykata Themelore e Prishtinës brenda saj ka tri Departamente të specializuara (D.Special, Administrativ dhe Ekonomik) me kompetence për tërë territorin e Kosovës.

Për kryerjen e funksioneve gjyqësore të Gjykatës Themelore në Prishtinë, janë të organizuara gjashtë (6) Departamente:

- Departamenti Special,
- Departamenti për Krime të Rënda;
- Departamenti për të Mitur;
- Departamenti Administrativ,
 - Divizioni Fiskal (është shuar në korrik të vitit 2022)
- Departamenti Ekonomik (Me krijimin e Gj.Komercile, nga Korriku 2021 është shuar si Departament)
 - Divizioni për investime të huaja,
- Departamenti i Përgjithshëm, në kuadër të së cilit funksionojnë këto Divizione:
 - Divizioni Penal
 - Divizioni Civil dhe
 - Divizioni për Kundërvajtje

Si një gjykatë e shkallës së parë, Gjykata Themelore e Prishtinës dhe katër degët e saj merren me të gjitha llojet e rasteve brenda territorit të komunave të lartcekura, si dhe për aktakuzat e Prokurorisë Speciale dhe lëndët administrative ka kompetence për krejt Kosovën).

Degët e gjykatës në Glllogoc, Graçanicë, Podujevë dhe Lipjan merren vetëm me rastet që bien në kompetencë të Departamentit të Përgjithshëm.

Aktualisht Gjykata Themelore në Prishtinë me degët në Podujeve, Lipjan, Glllogoc dhe Graçanicë, ka të angazhuar gjithsejtë 109 gjyqtar, përfshirë këtu edhe kryetaren e gjykatës (prej tyre 88 janë aktiv, një është i suspenduar, 20 janë në trajnim në Akademinë e Drejtësisë). Gjatë vitit 2022, janë pensionuar dy (2) gjyqtar dhe një (1) ka vdekur. Në gjashtë mujorin e parë të vitit 2022 pritet të pensionohen edhe dy gjyqtar.

Gjykata Themelore në Prishtinë me degët e gjykatës në Podujeve, Lipjan, Glllogoc dhe Graçanicë, përmes këtij raporti prezanton në mënyrë përmbledhëse punën e gjykatës për vitin (janar – dhjetor) 2022, duke prezantuar njëkohësisht të arriturat, sfidat gjatë kësaj periudhe raportuese, si në aspektin profesional ashtu edhe në atë administrativ, me qëllim të paraqitjes së volumit të punës së kryer në formë statistikore dhe tabelore.

Zyra e Kryetares

Zyra e Kryetares së gjykatës gjatë periudhës raportuese të vitit 2022, ka përfunduar 212 kërkesa të autoriteteve të shteteve të ndryshme (Ndihme Juridike Ndërkombëtarë), 269 kërkesa për përjashtim të gjyqtareve, 106 kërkesa për lirim të parakohshëm me kolegji penal, 567 kërkesa për rehabilitim ligjor dhe gjyqësore, janë lëshuar 1480 vërtetime për gjobe dhe vërejtje gjyqësore, 11 aktgjykime për bashkim të procedurës, janë kryer 224 aktvendime të cilat kenë qene kompetencë e Kryetares si dhe janë përfunduar 10.156 Ri-caktime të lëndëve përmes sistemit Smil.

Lidhur me procedurën disiplinore gjatë vitit 2022 nga palët janë pranuar 41 ankesa disiplinore ndaj gjyqtareve, përveç kësaj janë inicuar 4 hetime preliminare sipas detyrës zyrtare ndaj gjyqtareve (në total 45 raste disiplinore). Gjatë vitit 2022 janë proceduar në KGJK, 5 kërkesa për inicim të procedurës disiplinore, të tjerat janë refuzuar si të pabazuara.

Zyra e kryetares ka trajtuar të gjitha kërkesat të cilat janë drejtuar në këtë zyre duke përfshirë edhe kërkesat e institucioneve publike, OJQ-ve dhe mediave. Me shkrim janë kthyer 318 përgjigje drejtuar këtyre institucioneve, janë trajtuar 86 kërkesa për qasje në dokumente publike, si dhe zyra për informim ka trajtuar çdo kërkesë që ka pasur për qëllim informata nga palët qofte përmes shkresave apo emailit.

Gjykata Themelore e Prishtinës ka marrë edhe çmimin si gjykata ma transparente në Kosovë për vitin 2022.

Zyra për ekzekutimin e sanksioneve penale, e cila menaxhohet nga zyra e kryetares në këtë periudhë raportuese ka trashëguara 2845 lëndë ndërsa janë pranuar 2008 lëndë të reja dhe kanë arrite të përfundohen apo ekzekutohen gjithsej 2932 lëndë, prej tyre 400 lëndë janë ekzekutuar me burgim efektiv, 94 lëndë janë parashkruar, me mënyrë tjetër si pagese e dënimit me gjobë, rigjykim, masa etj. janë ekzekutuar 2438 lëndë.

Në ekzekutimet civile gjate periudhës një vjeçare janë pranuar 2290 lende ndërsa janë ekzekutuar 1652 lëndë nga 5 referent ekzekutues, ndërsa ne divizionin e kundërvajtjes janë trashëguar 3549 janë pranuar 1727 lende dhe janë ekzekutuar 2632 lende nga 2 referent ekzekutues.

Gjykata Themelore ne Prishtine gjithashtu ka lëshuar 35.425 certifikata për verifikim të kaluarës kriminale dhe vula apostile.

Zyra e Ndërmjetësimit në Gjykatën Themelore Prishtinë funksionon edhe për degët e saj referohen lëndë nga degët e gjykatës, nga Tetori i vitit 2022, zyra e ndërmjetësimit me ndihmën e Usaid – Drejtësia Komerciale funksionin edhe ne degën e Lipjanit dhe Podujevës.

Në zyrën e ndërmjetësimit në vitin 2022 nga muaji Janar deri në fund të Dhjetorit janë referuar gjithsej 2784 raste, prej të cilave 320 lende penale, 2459 lende civile dhe 5 ekonomike.

Prej 320 lëndë penale, 289 kanë përfunduar te zgjidhura me marrëveshje te ndërmjetësimit ndërsa 24 kanë dështuar. Prej 2459 lëndëve civile, 47 kanë përfunduar të zgjidhura me marrëveshje te ndërmjetësimit ndërsa 102 kanë dështuar për tu zgjidhur. Prej 5 lëndëve ekonomike, 3 kanë përfunduara të zgjidhura me marrëveshje te ndërmjetësimit ndërsa 2 kanë dështuar për tu zgjidhur. Gjithsej 340 lëndë të përfunduara me marrëveshje dhe 128 lëndë të dështuara ne ndërmjetësim. Në procedurë janë edhe 2318 lëndë.

Dega ne Podujeve prej momentit të funksionalizimit të ndërmjetësimit ne kete gjykate janë referuar gjithsej 30 lëndë penale prej të cilave janë kryer 19 lëndë penale ndërsa ndërmjetësimi ka dështuar në 10 lëndë.

Dega ne Lipjan gjatë vitit 2022 janë referuar gjithsej 54 lende prej tyre 42 lende janë zgjidhure ndërsa ndërmjetësimi ka dështuar në 11 lende.

Statistikat e lëndëve në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe dege

Gjatë kësaj periudhe kohore Gjykata Themelore në Prishtinë dhe Degët e saja kanë evidentuar në punë 43,513 lëndë gjyqësore, janë përfunduar 33.299 lëndë, ndërsa kanë mbetur të papërfunduara 82.339 lëndë.

Efikasiteti i Gjykata Themelore Prishtinë me dege për vitin 2022 është 76.52%

Gjykata Themelore në Prishtinë

1.0 Departamenti Special

Në këtë departamenti gjatë vitit 2022 kanë qenë të trashëguara 82 lënde ndërsa janë pranuar 77 lënde kanë arrite të përfundohen 42 lënde dhe kanë mbete në punë edhe 117 lëndë. **Ky departament për vitin 2022 ka arrit efikasitetin 54.55%**

1.1 Departamentin e Krimeve të Rënda

Ne Departamentin e Krimeve të Rënda janë trashëguar 1552 lënde gjatë vitit 2022 janë pranuar 709 lënde ndërsa janë përfunduar 639 lënde kanë mbete në punë edhe 1622. **Ky departament për vitin 2022 ka arrit efikasitetin 90.13%.**

1.2 Departamenti për të Mitur

Departamenti për të Mitur ka trashëguar 624 lënde ka pranuar 490 lënde dhe ka përfunduar 553 lënde, në punë i ka të mbetura edhe 561 lënde. **Ky departament për vitin 2021 ka arrit efikasitetin 112.86%.**

1.3 Departamenti për Çështje Administrative

Departamenti Administrativ ka trashëguar 6565 gjatë këtij viti ka pranuar 3290 lënde ndërsa ka arritur të përfundoj 2707 lënde i kanë mbete në punë edhe 7148. **Ky departament për vitin 2021 ka arrit efikasitetin prej 82.27%**

1.4 Departamenti për Çështje Ekonomike

Departamenti Ekonomik si i vetmi departament në Kosovë ka trashëguar 1927 lënde dhe pranuar 431 lënde ndërsa ka përfunduar 166 lënde të mbetura i ka edhe 2192 lënde. **Ky departament për vitin 2022 ka arrit efikasitetin 38.52%. (Nga muaji Korrik 2022, ky departament është shuar)**

1.5 Departamenti i përgjithshëm:

- Divizioni për Çështje Penale

Në këtë divizion gjatë vitit 2022 janë trashëguar 11191 lënde, janë pranuar 3668 lënde ndërsa janë përfunduar 3699 lënde, kanë mbetë në punë edhe 11160. **Ky departament ka arritur të ketë efikasitetin 100.85%.**

- Divizioni për Çështje Civile

Divizioni civil i cili është njeri ndër departamentet më të ngarkuara me lënde ka trashëguar 31.310 lënde, gjatë këtij viti ka pranuar 12090 ndërsa ka përfunduar 7792 (vlejnë të theksohet se ky departament ka arritur të zgjidhe 3017 lënde me shume se në vitin 2021 ku kanë qenë të zgjidhura 4775 lënde) dhe i kanë mbete në punë 35.608. **Ky departament ka arritur të ketë efikasitetin 64.44%.**

- Divizioni për Kundërvajtje

Në këtë divizion gjatë vitit 2022 janë trashëguar 6422 lënde ndërsa janë pranuar 6286 lënde ndërsa janë përfunduar 3514 lënde kanë mbete në punë edhe 9194. **Ky departament ka arritur të ketë efikasitetin 55.90%.**

Raport i përgjithshëm për gjykatë - Lemia Penale dhe Civile
Gjykata Themelore Prishtine

Periudha e raportimit :01.01.2022 - 31.12.2022

Penale	A. Lëndët në pritje në fillim të periudhës raportuese	B. Lëndët e pranuar në periudhën raportuese	Gjithsej në punë A+B	C. Lëndët e zgjidhura në periudhën raportuese	D. P. Lëndët në pritje në periudhën raportuese	Efikasiteti i gjykatës	Lëndët e vjetra në punë	Numri i gjyqtarëve
Penale përgjithshme Procedurë paraprake	152	490	642	396	246	80.82	63	
Penale përgjithshme Shqyrtimi gjyqësor	11191	3668	14859	3699	11160	100.85	5592	12
Krime të rënda Procedurë paraprake	94	716	810	588	222	82.12	17	
Krime të rënda Shqyrtim gjyqësor	1549	709	2258	637	1621	89.84	800	10
Penale të mitur procedurë paraprake	59	139	198	104	94	74.82	23	
Penale të mitur Shqyrtim gjyqësor	621	488	1109	549	560	112.50	158	3
Procedurë Paraprake- Departamenti Special	52	264	316	177	139	67.05	11	
Shqyrtim gjyqësor- Departamenti Special	82	77	159	42	117	54.55	34	12
Lëndë të pranuar me nën-lloj të lëndës të pa specifikuar dhe pa përfundim të regjistrimit	3	0	3	0	3	#DIV/0!	0	
Totali	13803	6551	20354	6192	14162	94.52	6,698	37

Civile	A. Lëndët në pritje në fillim të periudhës raportuese	B. Lëndët e pranuar në periudhën raportuese	G. Gjithsej në punë A+B	D. Lëndët e zgjidhura në periudhën raportuese	E. Lëndët në pritje në periudhën raportuese	Efikasiteti i gjykatës	Lëndët e vjetra në punë	Numri i gjyqtarëve
Kontestimore	25447	8041	33488	4494	28994	55.89	12459	30
Jokontestimore	504	328	832	225	607	68.60	238	
Permbarimore	5359	3721	9080	3073	6007	82.59	379	
Administrative	5936	2928	8864	2463	6401	84.12	1545	12
Administrative- Divizioni fiskal	629	362	991	244	747	67.40	62	
Ekonomike	1927	431	2358	166	2192	38.52	782	6
Kontestet lidhur me investitorët e huaj	4	2	6	0	6	0.00	3	
Kundërvajtje	6422	6286	12708	3514	9194	55.90	743	2
Totali	46228	22099	68327	14179	54148	64.16	16,211	50

2. Dega ne Podujevë

2.1 Divizioni për Çështje Penale

Në këtë departament janë trashëguar 452 lënde gjatë vitit 2022 janë pranuar 523 lënde ndërsa janë përfunduar 599 lënde dhe kanë mbetur në punë edhe 376 lënde.

Ky divizion ka arritur të ketë efikasitetin 114.53%.

2.2 Divizioni për Çështje Civile

Departamenti civil ka trashëguar 3520 lende, gjate kësaj periudhe ka pranuar 3362 ndërsa ka përfunduar 1994 lende ndërsa ne pune i ka edhe 4888.

Ky divizion ka arritur të ketë efikasitetin 59.30%

2.3 Divizioni për Kundërvajtje

Në këtë divizion gjatë vitit 2022 janë trashëguar 1579 lënde ndërsa janë pranuar 1478 lende ndërsa janë përfunduar 1245 lende kane mbete ne pune edhe 1812.

Ky divizion ka arritur te ketë efikasitetin 84.24%.

Raport i përgjithshëm për gjykatë - Lemia Penale dhe Civile
Dega e gjykatës Podujevë

Perioda e raportimit :01.01.2022 - 31.12.2022

Penale	A. Lëndët në pritje në fillimin e periudhës raportuese	B. Lëndët e pranuar në periudhën raportuese	C. Gjithsej në punë A+B	D. Lëndët e zgjidhura në periudhën raportuese	E. P. Lëndët në pritje në periudhën raportuese	EFikasiteti i gjykatës	Lëndët e vjetra në punë	Numri i gjyqtarëve
Penale përgjithshme Procedurë paraprake	12	63	75	55	20	87.30	3	
Penale përgjithshme Shqyrtimi gjyqësor	452	523	975	599	376	114.53	84	2
Krime të rënda Procedurë paraprake	1	0	1	0	1	#DIV/0!	1	
Krime të rënda Shqyrtim gjyqësor	0	0	0	0	0	#DIV/0!	0	
Penale të mitur procedura paraprake	0	1	1	1	0	100.00	0	
Penale të mitur Shqyrtimi gjyqësor	2	1	3	2	1	200.00	1	
Procedurë Paraprake- Departamenti Special	0	0	0	0	0	#DIV/0!	0	
Shqyrtim gjyqësor- Departamenti Special	0	0	0	0	0	#DIV/0!	0	
Lende të pranuar me nën-loj të lëndës të pa specifikuar dhe në	1	0	1	0	1	#DIV/0!	0	
Totali	468	588	1056	657	399	111.73	89	2

Civile	A. Lëndët në pritje në fillimin e periudhës raportuese	B. Lëndët e pranuar në periudhën raportuese	C. Gjithsej në punë A+B	D. Lëndët e zgjidhura në periudhën raportuese	E. Lëndët në pritje në periudhën raportuese	EFikasiteti i gjykatës	Lëndët e vjetra në punë	Numri i gjyqtarëve
Kontestimore	3140	2064	5204	1110	4094	53.78	1353	3
Jokontestimore	75	95	170	103	67	108.42	27	
Permbarimore	305	1203	1508	781	727	64.92	1	
Administrative	0	0	0	0	0	#DIV/0!	0	
Administrative- Divizioni fiskal	0	0	0	0	0	#DIV/0!	0	
Ekonomike	0	0	0	0	0	#DIV/0!	0	
Kontestet lidhur me Investitorët e huaj	0	0	0	0	0	#DIV/0!	0	
Kundërvajtje	1579	1478	3057	1245	1812	84.24	16	1
Totali	5099	4840	9939	3239	6700	66.92	1,381	3

3. Dega ne Lipjan

3.1 Divizioni për Çështje Penale

Në divizionin penal janë trashëguar 957 lënde ndërsa janë pranuar 576 lënde dhe kanë përfunduar 634 lënde në punë janë edhe 899 lënde.

Ky divizion ka arritur të ketë efikasitetin 110.07%.

3.2 Divizioni për Çështje Civile

Divizioni civil i ka te trashëguara 5118 lende, është njeri ndër departamentet me të ngarkuara me lënde gjatë këtij viti ka pranuar 2157 ndërsa ka përfunduar 1320 lënde dhe në punë i ka 5955.

Ky divizion ka arritur të ketë efikasitetin 61.19%.

3.3 Divizioni për Kundërvajtje

Në këtë divizion gjate vitit 2022 janë trashëguar 3404 lënde ndërsa janë pranuar 1645 lënde, të përfunduara 3234 lënde, kanë mbetë në punë edhe 1815.

Ky divizion ka arritur te ketë efikasitet 196.60%.

Raport i përgjithshëm për gjykatë - Lemia Penale dhe Civile
Dega e gjykatës Lipjan

Penale	A. Lëndët në pritje në fillimin e periudhës raportuese	B. Lëndët e pranuar në periudhën raportuese	C. Gjithsej në punë A+B	D. Lëndët e zgjidhura në periudhën raportuese	E. P. Lëndët në pritje në periudhën raportuese	Efikasiteti i gjykatës	Lëndët e vjetra në punë	Nomri i gjyqtarëve
Penale përgjithshme Procedurë paraprake	71	86	157	75	82	87.21	15	
Penale përgjithshme Shqyrtimi gjyqësor	957	576	1533	634	899	110.07	302	2
Krime të rënda Procedurë paraprake	0	3	3	2	1	66.67	0	
Krime të rënda Shqyrtim gjyqësor	3	0	3	2	1	#DIV/0!	1	
Penale të mitur procedura paraprake	0	1	1	1	0	100.00	0	
Penale të mitur Shqyrtimi gjyqësor	0	0	0	0	0	#DIV/0!	0	
Procedurë Paraprake- Departamenti Special	0	0	0	0	0	#DIV/0!	0	
Shqyrtim gjyqësor- Departamenti Special	0	0	0	0	0	#DIV/0!	0	
Lëndë të pranuar me nenin 107 të lëndës të pa specifikuar dhe në	0	0	0	0	0	#DIV/0!	0	
Totali	1031	666	1697	714	983	107.21	318	2

Civile	A. Lëndët në pritje në fillimin e periudhës raportuese	B. Lëndët e pranuar në periudhën raportuese	C. Gjithsej në punë A+B	D. Lëndët e zgjidhura në periudhën raportuese	E. Lëndët në pritje në periudhën raportuese	Efikasiteti i gjykatës	Lëndët e vjetra në punë	Nomri i gjyqtarëve
Kontestimore	2747	1182	3929	706	3223	59.73	1042	3
Jokontestimore	236	84	320	116	204	138.10	110	
Perbarimore	2135	891	3026	498	2528	55.89	140	
Administrative	0	0	0	0	0	#DIV/0!	0	
Administrative- Divizioni fiskal	0	0	0	0	0	#DIV/0!	0	
Ekonomike	0	0	0	0	0	#DIV/0!	0	
Kontestet lidhur me investitorët e huaj	0	0	0	0	0	#DIV/0!	0	
Kundërvajtje	3404	1645	5049	3234	1815	196.60	159	1
Totali	8522	3802	12324	4554	7770	119.78	1,451	4

4. Dega ne Glllogoc

4.1 Divizioni për Çështje Penale

Në divizionin penal janë trashëguar 216 lënde gjatë kësaj periudhe janë pranuar 345 lënde ndërsa janë përfunduar 372 lënde dhe në punë janë 189 lënde.

Divizioni penal ka arritur te ketë efikasitet 107.83%.

4.2 Divizioni për Çështje Civile

Divizioni civil ka trashëguar 3813 lënde, gjatë këtij viti ka pranuar 2168 ndërsa ka përfunduar 1515 dhe në punë i ka 4466 lënde. **Ky divizion ka arritur të ketë efikasitet 69.88%.**

4.3 Divizioni për Kundërvajtje

Në këtë divizion gjatë vitit 2022 janë trashëguar 1028 lënde, ndërsa janë pranuar 1126 lënde ndërsa janë përfunduar 1009 lënde, kanë mbete në punë edhe 1145.

Ky divizion ka arritur te ketë efikasitet 89.61%.

Raport i përgjithshëm për gjykatë - Lemia Penale dhe Civile
Dega e gjykatës Glllogoc

Penale	A. Lëndët në pritje në fillimin e periudhës raportuese	B. Lëndët e pranuar në periudhën raportuese	C. Gjithsej në punë A+B	D. Lëndët e zgjidhura në periudhën raportuese	E. P. Lëndët në pritje në periudhën raportuese	Efikasiteti i gjykatës	Lëndët e vjetra në punë	Numri i gjyqtarëve
Penale përgjithshme Procedurë paraprake	47	42	89	51	38	121.43	30	
Penale përgjithshme Shqyrtimi gjyqësor	216	345	561	372	189	107.83	54	1
Krime të rënda Procedurë paraprake	0	0	0	0	0	#DIV/0!	0	
Krime të rënda Shqyrtim gjyqësor	0	0	0	0	0	#DIV/0!	0	
Penale të mitur procedura paraprake	0	0	0	0	0	#DIV/0!	0	
Penale të mitur Shqyrtim gjyqësor	1	0	1	1	0	#DIV/0!	0	
Procedurë Paraprake-Departamenti Special	0	0	0	0	0	#DIV/0!	0	
Shqyrtim gjyqësor-Departamenti Special	0	0	0	0	0	#DIV/0!	0	
Lënde të pranuar me nenin 110 të lëndës të pa specifikuar dhe pa	1	1	2	0	2	0.00	0	
Totali	265	388	653	424	229	109.28	84	1

Civile	A. Lëndët në pritje në fillimin e periudhës raportuese	B. Lëndët e pranuar në periudhën raportuese	C. Gjithsej në punë A+B	D. Lëndët e zgjidhura në periudhën raportuese	E. Lëndët në pritje në periudhën raportuese	Efikasiteti i gjykatës	Lëndët e vjetra në punë	Numri i gjyqtarëve
Kontestimore	2928	1143	4071	617	3454	53.98	1352	3
Jokontestimore	120	100	220	85	135	85.00	81	
Permbarimore	765	925	1690	813	877	87.89	3	
Administrative	0	0	0	0	0	#DIV/0!	0	
Administrative- Divizioni fiskal	0	0	0	0	0	#DIV/0!	0	
Ekonomike	0	0	0	0	0	#DIV/0!	0	
Kontestet lidhur me investitorët e huaj	0	0	0	0	0	#DIV/0!	0	
Kundërvajtje	1028	1126	2154	1009	1145	89.61	41	1
Totali	4841	3294	8135	2524	5611	76.62	1,477	3

5. Dega ne Graqanice

5.1 Divizioni për Çështje Civile

Në këtë divizion janë trashëguar 1119 lende gjate kesaj periudhe jane pranuar 542 lende ndërsa janë përfunduar 454 lënde, në punë janë 1207 lënde. **Efikasiteti për këtë departament është 83.76%**

5.2 Divizioni për Çështje Penale

Në divizionin penal janë trashëguar 421 gjatë kësaj periudhe janë pranuar 179 lënde ndërsa janë përfunduar 149 lënde në punë 451 lënde. **Efikasiteti ka arritur në 83.24%.**

5.3 Divizioni për Kundërvajtje

Në këtë divizion gjate vitit 2022 janë trashëguar 348 lënde ndërsa janë pranuar 529 lënde ndërsa janë përfunduar 188 lënde kanë mbete në punë edhe 689. **Ky divizion ka efikasitet 35.54%.**

Raport i përgjithshëm për gjykatë - Lemia Penale dhe Civile
Dega e gjykatës Graçanica

Penale	A. Lëndët në pritje në fillimin e periudhës raportuese	B. Lëndët e pranuar në periudhën raportuese	C. Gjithsej në punë A+B	D. Lëndët e zgjidhura në periudhën raportuese	E. P. Lëndët në pritje në periudhën raportuese	Efikasiteti i gjykatës	Lëndët e vjetra në punë	Numri i gjyqtarëve
Penale përgjithshme Procedurë paraprake	20	36	56	24	32	66.67	6	
Penale përgjithshme Shqyrtimi gjyqësor	421	179	600	149	451	83.24	149	1
Krime të rënda Procedurë paraprake	0	0	0	0	0	#DIV/0!	0	
Krime të rënda Shqyrtim gjyqësor	0	0	0	0	0	#DIV/0!	0	
Penale të mitur procedura paraprake	0	0	0	0	0	#DIV/0!	0	
Penale të mitur Shqyrtimi gjyqësor	0	1	1	1	0	100.00	0	
Procedurë Paraprake- Departamenti Special	0	0	0	0	0	#DIV/0!	0	
Shqyrtim gjyqësor- Departamenti Special	0	0	0	0	0	#DIV/0!	0	
Lenda të pranuar me nuan- lejt të lëndës të pa specifikuar dhe pa	1	0	1	0	1	#DIV/0!	0	
Totali	442	216	658	174	484	80.55	155	1

Civile	A. Lëndët në pritje në fillimin e periudhës raportuese	B. Lëndët e pranuar në periudhën raportuese	C. Gjithsej në punë A+B	D. Lëndët e zgjidhura në periudhën raportuese	E. Lëndët në pritje në periudhën raportuese	Efikasiteti i gjykatës	Lëndët e vjetra në punë	Numri i gjyqtarëve
Kontestimore	731	251	982	229	753	91.24	369	2
Jokontestimore	305	142	447	166	281	116.90	164	
Permbarimore	83	149	232	59	173	39.60	1	
Administrative	0	0	0	0	0	#DIV/0!	0	
Administrative- Divizioni fiskal	0	0	0	0	0	#DIV/0!	0	
Ekonomike	0	0	0	0	0	#DIV/0!	0	
Kontestet lidhur me investitorët e huaj	0	0	0	0	0	#DIV/0!	0	
Kundërvajtje	348	529	877	188	689	35.54	35	1
Totali	1467	1071	2538	642	1896	59.94	569	3

Zyra e Personelit

Gjatë kësaj periudhe raportuese të vitit 2022, Gjykata ka publikuar konkursin për praktikante në periudhën një vjeçare nr.01/2022 të dt. 25.01.2021 në Gjykatën Themelore Prishtinë dhe degët e saj me 84 pozita, kjo procedurë e rekrutimit ka përfunduar me sukses dhe këta praktikant kanë filluar punën praktike me dt.24.02.2022. Gjykata ka publikuar konkursin e dyte për praktikante në periudhën një vjeçare nr.02/2022 të dt.22.09.2022 në Gjykatën Themelore Prishtinë me 40 pozita kanë filluar punën praktike me dt.18.10.2022. Gjykata ka publikuar konkursin nr.01/2022 për Gjyqtare Porotë në Gjykatën Themelore Prishtinë me dt.11.01.2022 për 39 pozita, procedurat kanë përfunduar, lista e gjyqtareve porotë është dërguar në KGJK për emërim.

Me dt.14.06.2022 kanë filluar punën (3) Bashkëpunëtorë Profesional të cilët janë rekrutuar nga KGJK-j si dhe me dt.17.11.2022 kanë filluar punën 21 Bashkëpunëtorë Profesional. Me dt.12.12.2022 kanë filluar punën (8) Zyrtar ligjor të cilët janë rekrutuar nga SKGJK.

Zyra e Përkthimeve

Aktualisht Gjykata Themelore në Prishtinë ka të sistemuar 5 përkthyes me kontrata të rregullta dhe 4 me marrëveshje për shërbime të veçanta. Përkundër kësaj, vazhdon të ketë vonesa në përkthim të shkresave (vendimeve dhe shkresave të lëndës), pasi që përkthyesit shumicën e kohës janë të angazhuar në seanca gjyqësore.

Zyra e Financave

Zyra e Financave vepron sipas Ligjit të Financave Publike, Rregulloreve mbi Menaxhimin e Financave, Udhëzimeve Administrative aktuale që janë në fuqi. Siç dihet në procesin e Decentralizimit, Gjykata Themelore e Prishtinës e ka pas të alokuar Buxhetin e vet sipas Programit të Kodit Organizativ 38100 dhe është përgjegjëse për shpenzimin e buxhetit në bazë të kërkesave të saj.

Buxheti i Gjykatës Themelore të Prishtinës është 6,042,400.73 € - Paga dhe Mëditje, 5,370,725.73 € -Mallra dhe Shërbime, 606,175.00 €- Shpenzime Komunale. 65,500.00 Euro

Në Gjykatën Themelore në Prishtinë kanë arritur gjithsejtë të procedohen për pagesë deri më 31.12.2022 , 3157 fatura (të zotuar, të shpenzuara dhe të Certifikuara). Gjithashtu në Zyrën për buxhet dhe financa gjatë këtij viti kemi pas probleme me regjistrimin e furnitorëve në Thesar (SIMFK) posaçërisht për shpenzime të përfaqësimit të Gjyqtarët Porotë. Mangësitë dhe vështirësitë në realizimin e detyrave është mungesa e buxhetit për realizimin e të gjitha kërkesave në Gjykatë dhe degët e saja.

Zyra e Certifikimit

Gjatë vitit- 2022 janë pranuar dhe janë kontrolluar aprovuar 3157 pagesa për Avokat, Ekspert, Porote, shërbimet komunale, reprezentacion, P.G, biletat për dorëzues si dhe shërbimet postare. Gjatë vitit-2022 janë proceduar në sistem Certifikuar(Aprovuar) 3157 pagesa ne vlerë prej 646,575.64 €. Gjatë vitit 2022 pengesat e hasura janë se lëndët të cilat janë sjelle për tu Certifikuar(Aprovuar) ka pasur shumë lënde(Fatura) të cilat kanë qenë me vonesë që kanë kaluar afatin ligjore ma shumë se (1) muaji.

Zyra e Logjistikes

Gjykata e Prishtinës në aspektin e logjistikës gjatë vitit 2022 është furnizuar me materiale të ndryshëm zyrtar, i shtypur, higjenik dhe me kompjuter të nevojshëm dhe të mjaftueshëm. Plotësimin e kërkesave të stafit për pajisje, inventar dhe furnizim me pajisje te teknologjisë informative, menaxhimin e zyrave me inventar, vlerësimin e gjendjes se inventarit dhe pajisjeve nëpër zyrë etj.

10.Zyra e Informimit Publik

Zyra për Informim Publik gjatë kësaj periudhe raportuese ka bërë informimin për aktivitetet dhe punët që janë kryer në gjykatë, ka mbajtur kontaktin me media duke dhënë informacione dhe njoftime për aktivitetet që zhvillohen brenda gjykatës, po ashtu është angazhuar për ngritjen e vetëdijësimin e opinionit publik duke ofruar informata rreth çështjeve të ndryshme në gjykatë, duke ndikuar në rritjen e besimit të qytetarëve të Republikës së Kosovës përmes dhënjes së informacioneve të ndryshme rreth gjykatës. Komunikimi, transparenca dhe qasja e lehtë e qytetarëve në shërbimet e Gjykatës, ka qenë një prej prioriteteve të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Zyra për Informim Publik në këtë periudhë raportuese në kuadër të Udhëzimit Administrativ (02/2016), për Anonimizimin dhe Publikimin e Aktgjykimeve të Plotfuqishme, ka vazhduar publikimin e aktgjykimeve të anonimizuara dhe së fundmi edhe të aktvendimeve, e që për këtë periudhë raportuese janë publikuar 5928 aktgjykime të anonimizuara në web-faqen e KGJK-së.

Web-portali i gjyqësorit edhe këtë periudhë ka shërbyer si urë lidhëse ndërmjet publikut dhe gjykatës, me qëllim të informimit të tyre me kohë rreth aktiviteteve në Gjykatë, orarit të seancave gjyqësore, vendimeve të formës së prerë, lajmërime publike si dhe informacione tjera të përditshme mbi veprimtarinë e Gjykatës.

Zyra për Informim Publik e kësaj gjykate gjatë kësaj periudhe ka bërë hartimin e komunikatave, përcjelljen e tyre tek mediat, monitorimin e mediave, përcjelljen e seancave gjyqësore, kthimin e përgjigjeve për mediat në koordinim me kryetaren e gjykatës, bashkëpunimin dhe kthimin e përgjigjeve në kërkesa të OJQ-ve të ndryshme, të cilat mbulojnë punën e gjykatave, sigurimin e qasjes së palëve, sigurimin e statistikave të ndryshme për rastet me interes për mediat, shoqërinë civile, studentët dhe qytetarët.

Zyra për Informim Publik e kësaj gjykate gjatë kësaj periudhe po ashtu ka kryer përgjegjësitë e zyrtarit për Qasje në Dokumente Publike, trajtimin e çdo kërkesë me shkrim dhe me emal nga avokatë, media, OJQ dhe qytetarë duke krijuar sigurimin e qasjes, bazuar në kërkesat e tyre.

11. Bashkëpunimi me organizatat jo qeveritare dhe qeveritare ndërkombëtare dhe vendore

Gjatë kësaj periudhe, Programi Drejtësia komerciale në kuadër të Agjencisë për Zhvillim të SHBA (JSSP – USAID), ka vazhduar me angazhimin zyrtarëve ligjor për rritjen e efikasitetit në procedurën alternative të zgjidhjes së lëndëve me ndërmjetësim.

Gjithashtu përgjatë vitit 2022 UNDP ka vazhduar bashkëpunimin me Gjykatën Themelore të Prishtinës duke mbështetur gjykatën me 4 përkthyes me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta në afat të caktuar 6 mujor, me mundësi vazhdimi edhe për 6 muaj tjerë si dhe me 8 zyrtar për regjistrim dhe asgjësim të lëndëve të arkivuara të natyrës së kundërvajtjes.

Gjithashtu përgjatë vitit 2022 USAID me projektin drejtësia Komerciale, e ka mbështet gjykatën me staf si dhe me dhënie të këshillave profesionale për avancimin e zyrës së ndërmjetësimit, si dhe ka ndihmuar në funksionalizimin e zyrave të ndërmjetësimit në Lipjan dhe Podujevë.

Gjatë kësaj periudhe kemi pasur bashkëpunim me institucione, veprimtaria e të cilave mund të ketë ndikim në aspektin e efikasitetit apo të ngritjes së besueshmërisë së opinionit publik në përgjithësi në gjykatë, si Policia e Kosovës, Shërbimi Sprovues i Kosovës, Prokurorisë Themelore, Prokurorisë Speciale, Komuna e Prishtinës etj.

Bashkëpunimi me institucionet tjera vendore, ndërkombëtare dhe shoqëritë civile ka vazhduar në kuadër të kompetencave që bartin dhe në respektim të memorandumeve të nënshkruara nga KGJK-ja.

Sidat me të cilat është ballafaquar Gjykata Themelore e Prishtinës gjatë vitit 2022

Përkundër angazhimeve dhe të arriturave, gjykata gjatë vitit 2022 është ballafaquar edhe me sfida të ndryshme të cilat kanë frenuar arritjet edhe më të mëdha që kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë synimi jonë.

Sfidat kryesore ka qenë, numri i madh i lëndëve dhe numri i vogël i gjyqtarëve, ku pothuajse secili departament dhe degë ndonjëra me pak e ndonjë më shumë është prek nga largimi i gjyqtareve në gjykata të shkalleve me të larta, pensionimi dhe arsyeja tjera çka realisht ka qenë sfide menaxhimi dhe shpërndarja e lëndëve tek gjyqtaret e tjerë dhe kjo patjetër që ka ndiku edhe në performancën e gjyqtareve në veçanti dhe gjykatës në tërësi. Po ashtu vazhdon me qenë sfide dhe me ndiku në statistika të përgjithshme numri i madh i lëndëve në ardhje, sidomos në civile dhe administrative. Si gjykata si pasoje e mungesës së gjyqtareve ka pas pengesa të mëdha në krijim të trupave gjyqësore. Kjo ngarkesë ka kërkuar angazhimin maksimal të gjyqtarëve, që pavarësisht faktit se janë zgjedhur në përbërje të trupave përkatëse, kryejnë detyrën edhe si pjesë e trupave të ndryshme gjyqësore.

Sfida më e madhe e Gjykatës ngelet numri tepër i madh i çështjeve të vjetra që presin për shqyrtim (backlog), numri i madh i çështjeve të grumbulluar ndër vite në gjykatë mbetet një problem shqetësues dhe një sfidë për veprimtarinë e saj, gjë që ka ndikim të drejtpërdrejtë në

ecurinë e procesit të administrimit të shpejtë dhe efektiv të drejtësisë. Ulja e numrit të lartë të çështjeve të vjetra kërkon kohë, por edhe një strategji koherente dhe frytdhënëse. Me qëllim të trajtimit të barabartë të palëve, gjyqtaret kanë vepruar sipas Planit Strategjik për përmirësimin e qasjes në drejtësi 2022-2025 dhe mendimeve të Këshillit të Etikes.

Sfide për gjyqësorin në përgjithësi, dhe këtu edhe për Gjykatën e Prishtinës, ka qenë sulmi i gjyqtareve, etiketimi dhe linçimi i tyre në raport me vendimet e marra. Pavarësia e gjyqësorit është lëkundur ndjeshëm në këtë vit nga një varg veprimesh të pushteteve tjera, qofte përmes kritikave, etiketimeve dhe përfoljes se gjyqtareve dhe familjareve të tyre, qofte duke u komentuar vendimet gjyqësore.

Andaj, vitit 2023 duhet të jetë i fokusuar më shumë kah obligimi që kemi për ti siguruar gjyqtaret me ndërmarrjen e të gjitha masave të nevojshme për siguri dhe mbrojtje të gjyqtarëve.

Gjatë vitit 2022 tepër shqetësuese ka qenë gjendja në Pallatin e Drejtësisë në kuptim të kushteve të punës, ku për shkak të mos funksionimit të sistemit të ajrosjes, si dhe sistemit të ftohjes dhe ngrohjes, kushtet e punës kane qenë shumë të rënuara, ku disa herë gjatë vitit jemi ballafaquar me alivanosje të stafit dhe të palëve për shkak të mungesës së ajrit të shëndetshëm në Pallat. Problem tjetër ka qenë defektet e kohëpaskohshme në ashensorët në objekte ku ka pas raste të shumta kur edhe janë ngujuar përdoruesit e ashensorëve brenda. Gjendja me ndriçim elektrik gjithashtu vazhdon me qenë problematike, pasi që nuk funksionin sistemi automatik i hapjes se ndriçimit elektrik për këtë arsye ndriçimi është lidhur në mënyrë të drejtpërdrejt ku 24 orë dritat elektrike rrinë të ndezura. Nga hyrja në sezonin e dimrit, sistemi i ngrohjes nuk funksionin fare, zyrat janë duke u ngrohur me nxemje elektrike që i kanë siguruar vet punëtorët e Pallatit të Drejtësisë, çka gjykatës do ti kushtoj me fatura të larta të shpenzimit të energjisë elektrike.

Këto shqetësime vazhdimisht i kemi ngritur me shkrim në KGJK dhe në Ministrinë e Punëve të Brendshme si institucioni që ka nën mbikëqyrje objektet e institucioneve shtetërore.

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë

Albina Shabani Rama

